



Udhëzuesi për komunikim të aksesueshëm



Caritas Shqiptar
Albania



Udhëzuesi për komunikim të aksesueshëm

Përgatitur:

Caritas Shqiptar

www.caritalbania.org / +355 (0) 68 202 4596

caritalbania@caritalbania.org

Adresa: Rr. Don Bosko Nr. 4 Tiranë, Shqipëri

Redaktor:

Joana Luka & Kaljana Elezi & Enkeleida Mataj

Tiranë, Janar 2024.



PËRMBAJTJA

- 2 HYRJE
- 3 KOMUNIKIMI ME PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA
- 4 UDHËZIME TË PËRGJITHSHME
- 4 KOMUNIKIMI ME PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË DËGJIM
- 5 KOMUNIKIMI ME PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË SHIKIM
- 6 KOMUNIKIMI ME PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA FIZIKE
- 6 KOMUNIKIMI ME PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA INTELEKTUALE
- 7 KRIJIMI I MATERIALEVE TË AKSESUESHME
- 7 KRIJIMI I MATERIALEVE TË SHKRUARA
- 8 PARAQITJA E TEKSTIT
- 9 FOTOGRAFI
- 10 PDF E AKSESUESHME DHE DOKUMENTE TË TJERA TEKSTUALE
- 11 PREZANTIMET E AKSESUESHME TË WEB-IT
- 13 AKSESUESHMËRIA NË RRJETET SOCIALE
- 15 PREZANTIMET E AKSESUESHME
- 16 UDHËZIME PËR ORGANIZIMIN E EVENTEVE TË AKSESUESHME
- 16 FTESË DHE REGJISTRIM NË EVENT
- 16 AKSESUESHMËRIA FIZIKE
- 17 KOMUNIKIMI PA BARRIERA
- 18 SIGURI PËR TË GJITHË

Hyrje

Udhëzuesi **Bazat e komunikimit të aksesueshem** është krijuar në kuadër të projektit **ACTIVE** - Komunikimi i aksesueshëm drejt gjithpërfshirjes të grupeve të cenueshme në Ballkanin Perëndimor (Accessible Communication Toward Inclusion of Vulnerable and Excluded persons on Western Balkans), me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe tërheqjes së vëmendjes ndaj problemit të aksesueshmërisë së pamjaftueshme, por edhe paraqitjen e zgjidhjeve të mundshme, më konkretisht me udhëzimet për përmirësimin e aksesueshmërië.

Projekti **ACTIVE** ka për qëllim zhvillimin e konceptit të komunikimit gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi, Mal të Zi dhe Kosovë*). Partnerët e projektit janë pjesë e rrjetit të Caritas-it dhe bashkëpunojnë në projekte të ndryshme, duke ndarë vlera dhe mision të përbashkët. Projekti mbështetet nga Caritas Austria dhe organizata Renovabis nga Gjermania.

Grupet e cenueshme, si personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, personat me vështirësi në të mësuar, përballen me shumë sfida kur bëhet fjalë për aksesueshmëri. Për shkak të barrierave të shumta në mjedis, zvogëlohen mundësitë e tyre për të kryer aktivitetet e përditshme në mënyrë të pavarur, për t'u përfshirë në shoqëri dhe për të realizuar potencialin e tyre personal.

Udhëzuesi përmban këshilla të dobishme për komunikim me personat me aftësi të kufizuara, udhëzime për krijimin e materialeve të aksesueshme dhe udhëzime për krijimin e faqeve të internetit të aksesueshme. Përveç kësaj, dokumenti përmban udhëzime të nevojshme për organizimin e eventeve të aksesueshme.



Komunikimi me persona me aftësi të kufizuara

Respektimi i dinjitetit të çdo personi dhe respektimi i të drejtave të njeriut në masë të madhe reflektohet në gjuhën që përdorim. Është e rëndësishme të përdoren terma jodiskriminues, gjuhë gjithëpërfshirëse dhe fjalor adekuat.

Opsioni më i mirë është të pyesni bashkëbiseduesin cilat fjalë ose terminologji preferohet të përdorni.

Nëse kjo nuk është e mundur, ju rekomandojmë ta përdorni gjuhën *people-first*, më konkretisht gjuhën që vendos personin në radhë të parë përpara aftësisë së kufizuar ose vështirësisë. Ky lloj i gjuhës nuk e sheh aftësinë e kufizuar si një veçori përcaktuese, por si një nga disa aspekte të një personi. Për shembull, termi “person me aftësi të kufizuara” duhet të përdoret në vend të fjalës “invalid”. Ky rekomandim i referohet edhe adresimit të njerëzve me sëmundje të ndryshme, për të cilat duhet të shmangen etiketimet mjekësore në mënyrë që të mos forcohen stereotipat për njerëz si “pacientë”.

Ndonjëherë mund të ndodhë që një person me aftësi të kufizuar të përdorë gjuhë jokorrekte, për shembull për t'u prezantuar se është invalid, por kjo nuk do të thotë që të tjerët duhet ta përdorin këtë terminologji.

Kur flasim për personat me aftësi të kufizuara, rekomandimi kërkon që të përdorim formën pozitive në gjuhë, si dhe të shmangim fjalët pasive dhe ofenduese, gjithmonë duke pasur parasysh respektimin e integritetit dhe dinjitetit të personit me aftësi të kufizuara.

Udhëzime të përgjithshme:

- Drejtohuni personit drejtpërdrejt, jo ndihmësit/ndërmjetësit të tij/saj.
- Nëse nuk jeni të sigurt çfarë të bëni kur dëshironi të ndihmoni një person me aftësi të kufizuara, duhet ta pyesni atë.
- Nëse ofroni ndihmë, prisni që personi të pranojë, pastaj dëgjoni atë që thotë ose kërkon udhëzime.
- Nuk duhet të ndiheni në siklet nëse përdorni shprehjet e zakonshme, si: “Shihemi më vonë” ose “Dëgjohemi”.
- Kur jeni në shoqërinë e një personi me aftësi të kufizuara, duhet të jeni të natyrshëm dhe të drejtpërdrejtë, pa mirësjellje, keqardhje apo hezitim të tepruar.
- Shmangia ose injorimi i një personi me aftësi të kufizuara është një formë e diskriminimit të fshehur.



Ashtu si në komunikim me njerëzit pa aftësi të kufizuara, nëse bëni një gabim, kërkon falje, korrigjoni gabimin, mësoni prej tij dhe vazhdoni tutje.



Komunikimi me personat me aftësi të kufizuara fizike

- Vendosni kontakt me sy dhe flisni drejtpërdrejt me personin me aftësi të kufizuara fizike.
- Kurdo që është e mundur, uluni për të biseduar me personin që është me karrocë në mënyrë që sytë tuaj të jenë afërsisht në të njëjtin nivel.
- Kur takoni një person me lëvizshmëri të kufizuar të duarve ose që përdor një protezë për gjymtyrët e sipërme, mos e shmangni shtrëngimin e duarve. Mund të shtrëngoni duart me prekje, me dorën e majtë ose ashtu siç i përshtatet më së miri personit me aftësi të kufizuara.
- Kur u jepni udhëzime personave me aftësi të kufizuara fizike, merrni parasysh distancën, kushtet e motit dhe pengesat fizike, si shkallët, skajet e trotuareve dhe sipërfaqet e pjerrëta.
- Nëse një person përveç aftësisë së kufizuar fizike ka edhe vështirësi në të folur:
 - mos supozoni se nuk mund ta kuptojë të folurit tuaj;
 - jini të durueshëm, mos u përpiqni t'i përfundoni fjalitë për të;
 - parashtroni pyetje që kërkojnë vetëm përgjigje të shkurtra, lutini të përsërisin atë që kanë thënë nëse nuk keni kuptuar.

Komunikimi me personat me shikim të dëmtuar

- Kur përshëndetni një person me një shkallë më të lartë të dëmtimit të shikimit, gjithmonë prezantoni veten, mos harroni të prezantoni të tjerët që janë me ju.
- Kur flisni në një grup që përfshin edhe një person të verbër, identifikoni gjithmonë personin me të cilin po flisni.
- Gjithmonë kthehuni drejt personit me të cilin po flisni.
- Përdorni lartësinë e zakonshme të zërit - mos flisni me zë shumë të lartë.
- Njoftoni personin kur largoheni nga zona dhe po përfundoni bisedën.
- Jini specifik me çdo udhëzim verbal.
- Mos supozoni se personi nuk sheh asgjë - është në rregull të pyesni çfarë sheh.
- Nuk duhet të ndiheni në siklet nëse përdorni shprehjet si: “Shihemi më vonë”. Ose “A e pe...?”.
- Mos e lëvizni bastunin e personit me aftësi të kufizuara pa leje.

Komunikimi me personat me dëgjim të dëmtuar

- Kur komunikoni me personat me dëgjim të dëmtuar, në fillim të bisedës zbuloni se cilat metoda komunikimi mund dhe duan të përdorin.
- Pozicionohuni aty ku mund të ju shohin për të tërhequr vëmendjen e tyre ose prekini lehtësisht mbi supe.
- Mbyllni dyert dhe/ose dritaret për të eliminuar ose minimizuar zhurmën e jashtme dhe shpërqendrimet.
- Zini vend në atë pozicion në mënyrë që fytyra juaj të jetë e ndriçuar në maksimum.
- Gjithmonë shikoni personin drejtpërdrejt në fytyrë - mos e ktheni kokën dhe mos e mbuloni gojën.
- Flisni qartë, natyrshëm dhe ngadalë duke vlerësuar nëse personi mund të lexojë buzët.
- Flisni pa i theksuar fjalët së tepërmi.
- Mos e ngrini zërin, përveç nëse ju kërkohet në mënyrë specifike. Flisni me një ton normal, pa të bërtitura.
- Shmangni detajet e panevojshme - jini të konçiz.
- Sipas nevojës, përdorni laps dhe letër për komunikim.
- Jini fleksibil – nëse personi nuk kupton diçka që ju thoni, riformulojeni në vend që ta përsërisni.

Komunikimi me personat me aftësi të kufizuara intelektuale

- Përdorni fjali të thjeshta, të drejtpërdrejta ose plotësuese, mënyra vizuale të komunikimit, si gjestet, diagramet ose treguesit.
- Shmangni zhargonin.
- Përdorni gjuhë konkrete, shmangni shprehjet abstrakte.
- Sa herë që është e mundur, përdorni fjalë që lidhen me atë që shihni të dy.
- Jini të përgatitur për të përsëritur të njëjtin informacion disa herë në mënyra të ndryshme.
- Përdorni gjuhë të qartë dhe të thjeshtë.

Materialiet

Në përgjithësi:

- Gjithmonë duhet ta keni parasysh se për kë janë të destinuara materialet që krijoni.
- Zgjidhni mënyrën më adekuate për transferimin e informacionit (material të printuar, material video ose të ngjashme).
- Uleni nivelin e njohurive të kërkuara paraprakisht për të kuptuar informacionin të cilin dëshironi ta marrë personi.
- Përfshini grupin e synuar sa më shumë që të jetë e mundur, qoftë në procesin e përzgjedhjes së temave, krijimit të materialeve apo kontrollimit të kuptueshmërisë.
- Gruponi përmbajtjet në njësi kuptimplota dhe të lidhura.
- Është në rregull të përsëritni informacione të rëndësishme.

Prodhimi i materialeve të shkruara:

- Përdorni fjalë të thjeshta dhe të kuptueshme.
- Shmangni fjalët e huaja dhe të ndërlikuara.
- Fjalët e ndërlikuara duhet të shpjegohen më tej.
- Mos përdorni metafora.
- Mos përdorni shkurtesa, si etj. psh. dhe të ngjashme.
- Shkruani numrat si shifra, jo si tekst, pra 1, 2 dhe jo një, dy.
- Mos përdorni numra romakë.
- Shkruani datat me numra 15. 8. 2023
Mos shkruani 15 gusht 2023.
- Përqindjet (65%) dhe numrat e mëdhenj (1.625.453) nuk janë të lehtë për t'u kuptuar.
- Tabelat dhe grafikët mund të jenë të vështirë për t'u kuptuar.
- Mos përdorni karaktere speciale si \$, #, & dhe të ngjashme.
- Drejtojuni drejtpërdrejtë, përdorni fjalë si “ti” dhe “ju”.
- Mundohuni të përdorni kohën e tashme.

- Mundohuni të shkruani fjali pozitive dhe aktive, në vend të atyre negative dhe pasive:
- Mos u largoni para përfundimit të takimit.
- Qëndroni deri në fund të takimit.
- Do të bëhet torte.
- Unë do të bëj tortë.
- Çdo fjali fillon në një rresht të ri.
- Një fjali duhet të përfaqësojë një ide, një mendim.
- Mundohuni ta vendosni fjalinë në një rresht.

Nëse fjalia ndahet në dy rreshta, shkëputeni fjalinë ku do të kishte një pauzë kuptimplotë gjatë leximit:

- Përbërësit e nevojshëm për të bërë tortën janë në frigorifer.
- Përbërësit e nevojshëm për të bërë tortën janë në frigorifer.
- Mos i shkëpusni fjalët në dy rreshta duke përdorur vijën “-“.
- Teksti duhet të jetë i rreshtuar [alignment] majtas, rreshtimi [alignment] në dy anët nuk është i lehtë për t'u lexuar.

Paraqitja e tekstit

- Përdorni madhësinë e dokumentit A4 ose A5.
- Kini kujdes lidhur me gjatësinë e dokumentit.
- Më mirë disa dokumente më të vogla sesa një dokument tepër i madh.
- Kujdesuni për kontrastin e ngjyrave të tekstit dhe sfondit.
- Asnjëherë mos përdorni imazhe ose ngjyra si sfond.
- Shembull
- Gjithmonë përdorni llojin e shkronjave [font] që lexohet lehtë, si Arial, Verdana, Calibri ose Tahoma.
- Mos përdorni fontet që kanë Serif në emër.
- Këto fonte janë më të vështira për t'u lexuar për shkak të përmasave të shkronjave.
- Fonti me emër Century nuk është i lehtë për t'u kuptuar.
- Fonti me emër Times New Roman nuk është i lehtë për t'u kuptuar.
- Gjithashtu, fontet ku shkronjat janë shumë afër ose shumë të ndritshme nuk janë të lehta për t'u lexuar.
- Fonte të tilla janë Gill ose Candara Light.
- Mos përdorni të shkronja në italike [kursiv] ose nënvizimet.

- Madhësia e rekomanduar e shkronjave është të paktën 14 pt.
- Pra, stili i rekomanduar është Arial 14.
- Hapësira e rekomanduar është 1.5.
- Mos shkruani gjithçka me shkronja të mëdha.
- Përdorni shkronja të vogla dhe të mëdha në përputhje me drejtshkrimin e gjuhës.
- Shmangni tekstin me ngjyra.
- Kur përdorni përemra vetorë, sigurohuni që të dihet se kujt i referohen.
- Nëse nuk jeni të sigurt nëse do të jetë e qartë se kujt i referohet përemri, përdorni emrin e personit.
- Mos përdorni fusnota.
- Listimin taksativ bëjeni me pika të veçanta në vend të paraqitjes në një rresht.
- Nëse është e mundur, numrat e faqeve paraqitini në formën “faqe 3 nga 10”.

Imazhet

- Imazhet lehtësojnë të kuptuarit e tekstit dhe tregojnë se për çfarë flet teksti.
- Imazhet mund të jenë:
 - o fotografi
 - o vizatime
 - o simbole.
- Sigurohuni që të përdorni të njëjtin stil ilustrimi përgjatë gjithë tekstit.
- Gjithmonë zgjidhni imazhe që janë të qarta dhe ilustrojnë mirë tekstin.

Shembull

- (Për një term specifik, përdorni gjithmonë të njëjtin imazh.) Përdorni të njëjtin imazh për të shpjeguar të njëjtin koncept.

SHEMBULL: TEMA E PERSONAVE ME VIZION TË DËMTUAR



A është mjaft e qartë se personi në foton në të djathtë po përdor programin e të folurit për shkak të dëmtimit të shikimit?

PDF i aksesueshëm dhe dokumente të tjera tekstuale

- Përdorni mjete të duhura për të krijuar PDF. Kur krijoni një material PDF, përdorni mjete që mbështesin aksesueshmërinë, si Adobe Acrobat Pro, Microsoft Word me opsionin për të ruajtur si PDF ose programe të tjera të ngjashme.
- Struktura e dokumentit: Përdorimi i titujve, nëntitujve dhe shenjave për të organizuar dhe shënuar strukturën e dokumentit (Heading 1, 2, 3...). Kjo i ndihmon personat me aftësi të kufizuara të “navigojnë” më lehtë nëpër dokument.
- Përmbajtja e tekstit: Sigurohuni që e gjithë përmbajtja tekstuale (teksti, tabelat, etj.) të jetë tekst real dhe jo vetëm imazhe ose dokumente të skanuara. Përmbajtja tekstuale mund të kërkohet dhe lexohet duke përdorur softuerin për lexim të ekranit ndërsa lexuesit e ekranit [screen reader] nuk mund të lexojnë dokumente dhe imazhe të skanuara.
- Teksti alternativ për imazhet: Nëse përdorni imazhe ose grafikë, jepni tekst alternativ (alt tekst) që përshkruan përmbajtjen e imazhit. Teksti alternativ u shpjegon përdoruesve të lexuesit të ekranit se çfarë mund të shihet në foto.
- Tabelat e aksesueshme: Nëse përdorni tabela, ofroni tituj të përshtatshëm, përshkrime të qelizave dhe shënjimimin e tabelës për të lejuar navigim dhe kuptim më të lehtë.
- Kontrasti i ngjyrave: Sigurohuni kontrast të mirë midis tekstit dhe sfondit për të lehtësuar leximin për njerëzit me shikim të dëmtuar.
- Renditja e saktë e leximit: Sigurohuni që renditja e leximit të tekstit të jetë logjike dhe të korrespondojë me strukturën aktuale të dokumentit.
- Linku me referencat e tekstit: Nëse përdorni hyperlink, sigurohuni që linqet t'u referohen referencave të tekstit që përshkruajnë qartë destinacionin e linkut.
- Për më tepër, përmes tekstit, shpjegoni grafikët e ndërlikuar [pie charts] dhe grafikat tjera që përcjellin informacion specifik statistikor.
- Tag dhe metadata: Tag i duhur i dokumentit dhe shtimi i metadata përkatëse lejon që softueri i lexuesit të ekranit të interpretojë dokumentin më mirë.

WEB-PREZANTIMET E AKSESUESHME

Shërbimet e aksesueshme në internet dhe web-prezantimet kontribuojnë në përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në botën digjitale, duke u ofruar atyre shanse të barabartë në informacion, produkte dhe shërbime, në të njëjtën mënyrë si personave pa aftësi të kufizuara, duke promovuar barazinë sociale.

Ekzistojnë standarde ndërkombëtare për krijimin e faqeve të internetit të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, ndërsa më të përdorurat janë standardet WCAG (Web Content Accessibility Guidelines), të cilat u zhvilluan nga World Wide Web Consortium (W3C).

Përdorimi i HTML semantike është një hap i rëndësishëm në krijimin e një web-lokacioni të aksesueshëm.

- **Siguroni tekstin alternativ për imazhet. Përdorni atributin “alt” për të siguruar tekst alternativ për imazhet.** Kjo ofron një përshkrim tekstual të imazhit për përdoruesit që nuk mund ta shohin atë.
- **Përdorni shenjën P për të ndarë blloqet e tekstit në paragrafë.** Kjo e bën më të lehtë për të gjithë përdoruesit të lexojnë dhe kuptojnë përmbajtjen në web-lokacionin tuaj.
- **Përdorni tekstin përshkrues të linkut që komunikon qartë destinacionin e vegëzes.** Shmangni përdorimin e tekstit gjenerik të përgjithshëm të linkut, siç janë “kliko këtu” ose “lexo më shumë”.
- **Siguroni titrat për videot dhe transkriptet për audio skedarë.** Kjo është e domosdoshme për përdoruesit që janë të shurdhër ose me vështirësi në dëgjim, si dhe për përdoruesit që nuk mund të kenë akses në përmbajtje audio ose video.
- **Përdorni menytë e navigimit dhe butonat që janë lehtësisht të aksesueshëm nga tastiera.** Sigurohuni që të gjithë elementët ndërveprues, siç janë formularët, butonat dhe linqet, mund të aksesohen edhe me tastierë.
- **Sigurohuni që të ketë kontrast të mjaftueshëm midis ngjyrave të tekstit dhe sfondit.** Sugjerojmë që raporti minimal i kontrastit midis tekstit dhe sfondit të jetë 4,5:1 për tekst normal dhe 3:1 për tekst të madh.

- **Përdorni animacione vetëm kur është e nevojshme dhe kur ka qëllim të qartë.**

Siguroni kontrollë për animacion, si butonat për rifillim, pauzë dhe ndalje, për të lejuar përdoruesit të kontrollojnë animacionin dhe shpejtësinë e tij. Siguroni përmbajtje alternative për animacionet, siç janë përshkrimi e tekstit ose transkripta, për të siguruar që përdoruesit me shikim të dëmtuar mund të kuptojnë përmbajtjen e animacionit.

Janë disa shtojca [add-ins] në dispozicion që mund të ndihmojnë që ueb-lokacioni juaj të jetë më i qasshëm për përdoruesit me aftësi të kufizuara.

Këtu janë disa shtojca të popullarizuara: WP Accessibility, Accessibility Widget, Accessible Poetry, Accessibility Enabler, UserWay Accessibility Widget, All Accessible.

Këto shtojca mund të ndihmojnë që web-lokacioni juaj të jetë më i aksesueshëm për përdoruesit me aftësi të kufizuara. Megjithatë, duhet të theksohet se këto shtojca duhet të përdoren bashkë me praktikatat e tjera më të mira të aksesueshmërisë, siç janë përdorimi i HTML semantik, ofrimi i tekstit alternativ për imazhet dhe sigurimi i aksesit me tastierë.

Udhëzime më të hollësishme për krijimin e web-faqeve të aksesueshme të internetit, mund t'i shkarkoni nga www.caritalbania.org



Udhëzime më të hollësishme për krijimin e web-faqeve të aksesueshme të internetit, mund t'i shkarkoni:
<http://caritalbania.org/category/broshura/>

AKSESUESHMËRIA NË RRJETET SOCIALE

#1: Postimi i fotografive pa tekst të tepërt.

#2: Shmangni postimet vetëm me fotografi.

Është e domosdoshme të shtoni tekst përshkrues për fotot në postimet në Facebook. Në këtë mënyrë, personat e verbër dhe me shikim të dobët do të lexojnë dhe kuptojnë postimet më lehtë.

#3: Tekstet alternative

Kur lexuesit e ekranit vijnë te fotografite në postim, ata do të lexojnë tekstin alternativ të shkruar dhe do t'u përcjellin mesazhin e qartë personave me shikim të dëmtuar lidhur me temën në foto. Teksti alternativ nuk është i njëjtë me tekstin që shkruhet në titujt e fotografive.

#4: Mundësoni titrat dhe transkriptet në video materiale.

Transkriptet u lejojnë personave me dëgjim të dëmtuar ose të reduktuar të ndjekin përmbajtjen e videos përmes tekstit. Transkriptet duhet të jenë të sakta dhe të detajuara, duke përshkruar të gjitha informacionet e rëndësishme vizuale dhe dialogun. Përveç transkriptit, video materialeve i shtohen edhe titrat, të cilat ndihmojnë personat me dëgjim të dëmtuar të ndjekin dialogun. Njëkohësisht, përkthimet në gjuhë të tjera lejojnë qasjen për njerëzit që nuk e flasin ose nuk e kuptojnë gjuhën.

#5: Kufizoni numrin e emotikonëve dhe emoji.

Emotikonët dhe emoji të vendosura në një postim në Facebook do të lexohen falë lexuesit të ekranit. Emoji J, për shembull, do të lexohet si: Një fytyrë e buzëqeshur me sy të buzëqeshur. Jini të vëmendshëm ndaj përdoruesve të lexuesve të ekranit duke kufizuar përdorimin e emotikonëve.

#6: Mos përdorni fonte dekorative në profil ose në titra.

Shkronjat dekorative janë 100% të pakuptueshme për lexuesit e ekranit. Një lexues ekrani mund të ngelet i heshtur kur lexon fjalë të shkruara me një font dekorativ ose mund të lexojë një sekuencë të palogjikshme fjalësh.

#7: Përdorni saktë #hashtag.

Hashtag është shpesh një kombinim i disa fjalëve, të cilat duhet të shkruhen pa hapësira. Nëse e përdorni, sigurohuni që të ketë kuptim dhe të lidhet me përmbajtjen e postimit tuaj. Shmangni përdorimin shumë të shpeshtë të hashtag. Hashtag duhet të shkruhet në mënyrë që çdo fjalë në përbërjen e saj të fillojë me një shkronjë të madhe (#HashTag|ShkruarMirë).

#8: Përdorni gjuhë të qartë dhe të thjeshtë në postime.

Shkruani qartë dhe thjesht në mënyrë që postimi të jetë i kuptueshëm. Ndani postimin tuaj në paragrafe ose seksione të shkurta për ta bërë më të lehtë për t'u lexuar dhe kuptuar, veçanërisht për njerëzit me vështirësi në lexim. Përdorni një titull përshkrues që përfaqëson me saktësi përmbajtjen e postimit tuaj dhe nëse ndani linkun me përmbajtje të tjera, përfshini një përshkrim të shkurtë që i ndihmon përdoruesit të kuptojnë se ku do t'i çojë linku.

#9: Zgjedhja e kontrastit, fonteve dhe detajeve me postime

Kontrasti i lartë midis ngjyrave të tekstit dhe sfondit përmirëson lexueshmërinë, e bën më të lehtë dallimin e elementeve dhe zvogëlon përpjekjen e kërkuar për të lexuar.

#10: Linqet

Nëse ndani linqe me përmbajtje jashtë rrjetit, sigurohuni që linku të ketë tekst përshkrues që përshkruan qartë përmbajtjen e destinacionit të linkut.



Udhëzime më të hollësishme për krijimin e web-faqeve të aksesueshme të internetit, mund t'i shkarkoni:
<http://caritalbania.org/category/broshura/>

PREZANTIMET E AKSESUESHME

Prezantimet e qasshme janë të rëndësishme për t'i lejuar të gjithë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të ndjekin dhe kuptojnë përmbajtjen e prezantimit tuaj. Ja disa hapa kryesorë për krijimin e prezantimeve të qasshme:

1. Përdorni një strukturë të qartë dhe konkrete:

- Organizoni prezantimin tuaj në mënyrë logjike, duke përdorur tituj dhe nëntituj të qartë.
- Përdorni numra ose shenja për ta bërë më të lehtë ndjekjen e renditjes së informacioneve.

2. Zgjidhni ngjyra kontrasti:

- Përdorni ngjyra që kanë kontrast të mirë për ta bërë tekstin më të lehtë për t'u lexuar.
- Shmangni përdorimin e ngjyrave që janë të vështira për t'u dalluar nga njëra-tjetra.
- Shmangni sfondet me ngjyra të ndezura.

3. Përdorimi i fonteve dhe madhësive të duhura të shkronjave:

- Përdorni fonte të lexueshme, si Arial, Calibri ose Verdana.
- Kujdesuni që madhësia e shkronjave të jetë mjaft e madhe për t'u lexuar.

4. Shtimi i transkriptimeve për audio dhe video përmbajtjen:

- Nëse përfshini audio ose video materiale, siguroni transkripta ose titra për të lejuar personat me dëgjim të dëmtuar ose ata që nuk e kuptojnë gjuhën të ndjekin përmbajtjen.

5. Përdorni gjuhë të thjeshtë:

- Shmangni fjalitë e ndërlikuara dhe terminologjinë teknike që mund të jete e vështirë për t'u kuptuar.
- Mos shkruani shumë tekst në prezantime, por vetëm termat bazë dhe më të rëndësishëm.

6. Jepuni njerëzve më shumë kohë për të kuptuar:

- Nëse përdorni animacione ose slajde me kalime automatike, lejojini përdoruesit të kenë kontroll mbi shpejtësinë e paraqitjes ose shqyrtimit të përmbajtjes.

7. Përdorni shenjat e navigimit:

- Aktivizoni shenjat e navigimit në mënyrë që përdoruesit të mund të navigojnë lehtësisht nëpër prezantim, veçanërisht nëse përdorin lexues ekрани.

8. Përdorni tekstin alternativ për imazhet:

- Nëse ia dërgoni prezantimin tuaj pjesëmarrësve të takimit dhe keni përdorur imazhe ose grafikë, siguroni tekst alternativ (alt tekst) që përshkruan përmbajtjen e imazhit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për personat me shikim të dëmtuar.

UDHËZIME PËR ORGANIZIMIN E EVENTEVE TË AKSESUESHME

Gjatë organizimit të ndonjë eventit, duhet pasur kujdes që eventit të jetë i aksesueshëm për të gjithë personat, pra pa pengesa fizike dhe në komunikim, në mënyrë që të gjithë të mund të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në të.

Këto udhëzime mund të ndihmojnë në planifikim, përgatitje dhe realizim të një eventeve të aksesueshme, pra një event pa barriera.

1. FTESA DHE REGJISTRIMI NË EVENT

Të kuptuarit se eventit është i aksesueshëm mund të jetë faktori vendimtar që dikush të vendos nëse do të marr pjesë ose jo në atë event.

Të rëndësishme:

- planifikim i detajuar para vetë eventit;
- informacionet për aksesueshmëri të eventit të jenë lehtësisht të disponueshme;
- duhet të jetë në dispozicion njoftimi për pjesëmarrësit potencial të eventit (faqja duhet të jetë e aksesueshme, ftesat ose fletëpalosjet duhet të jenë të shkruara në gjuhë të lehtë dhe të thjeshtë);
- nëse ka formular aplikimi, duhet të renditen edhe pyetje shtesë, si psh: a keni nevojë për asistencë shtesë, çfarë lloji? A ndiqni dietë të veçantë, çfarë lloji? Etj.;
- pyesni për nevojat e pjesëmarrësve të eventit;
- mundësoni praninë e asistentëve personalë.

2. AKSESUESHMËRIA FIZIKE

Kur planifikoni vendin për realizimin e eventit, është e rëndësishme të merrni parasysh aksesin fizik dhe disponueshmërinë.

Të rëndësishme:

- duhet të ketë akses në transport publik për të arritur në vendin e eventit dhe të mos jetë shumë larg qytetit;
- së bashku me ftesën, duhet të përfshihen udhëzime si të arrihet në vendin e eventit;
- duhet vendosen tabela me shkronja të mëdha, piktograme dhe shigjeta orientuese;
- nëse është e mundur, duhet të hiqen të gjitha barrierat fizike;
- nëse ka barriera fizike, duhet të sigurohet një zgjidhje alternative – pjerrësira, platforma, ashensor, etj.;

- në lokacion duhet të ketë ashensor nëse është objekt me disa kate;
- ashensorët duhet të jenë me dimensione të caktuara dhe të kenë sinjalistikë zanore, taktile dhe vizuale;
- shkallët duhet të kenë sipërfaqe që nuk rrëshqet dhe parrak;
- objekti duhet të ketë tualet të përshtatur;
- dhomat brenda ndërtesës duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme, pa shkallë, me dyshe me të lëmuara, me shiritat taktile në tokë dhe dritare që hapen lehtësisht;
- tavolinat dhe karriget duhet të vendosen në mënyrë që njerëzit në karrocë të lëvizin lirshëm;
- të mundësohet që personat me dëgjim të dëmtuar, të shurdhër, me vështirësi në dëgjim dhe me shikim të dobët të ulen përpara;
- pauzat duhet të zgjasin të paktën 20 minuta dhe duhet të planifikohen çdo 90 minuta;
- banaku duhet të jetë i zbritur për përdoruesit e karrocave ose të jetë i pranishëm një person për të ndihmuar të verbrit dhe njerëzit me vështirësi në lëvizje;
- duhet të shënohen dhe shkruhen qartë me shkronja më të mëdha përbërësit e ushqimit dhe pijeve, përbërësit alergjikë, si dhe servirjet për regjime të veçanta diete (vegjetariane, hallall, vegane etj.).

3. KOMUNIKIM PA PENGESA

Është rekomandim i përgjithshëm që në çdo event të flisni qartë, në mënyrë të artikuluar dhe jo shumë shpejt, në mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit e eventit të mund të ndjekin prezantimet dhe diskutimet.

Është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje këtyre:

- Personat me dëgjim të dëmtuar ndonjëherë kanë nevojë edhe për teknologji ndihmëse (sistemi FM dhe mikrofona).
- Transmetimi i drejtpërdrejtë në internet dhe regjistrimi i eventit janë veçanërisht të dobishme për njerëzit që nuk mund të marrin pjesë në atë event.
- Pjesëmarrja on-line duhet të jetë një mundësi shtesë dhe jo zëvendësim për një event të pa-aksesueshëm.
- Nëse në event marrin pjesë persona të shurdhër ose me vështirësi në dëgjim, është e rëndësishme të sigurohet një përkthyes i gjuhës së shenjave.
- Transkriptimi i të folurit të drejtpërdrejtë ose i video materialit (titrim) është shumë i dobishëm për njerëzit e shurdhër ose me vështirësi në dëgjim.

- Përdorni gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, si në gjuhën e folur ashtu edhe në të shkruar, për të siguruar që përmbajtja të kuptohet nga personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe pjesëmarrësit e tjerë, siç janë të moshuarit, njerëzit me nivele më të ulëta arsimore ose njerëzit që nuk e kuptojnë mirë gjuhën zyrtare të eventit.
- Siguroni materiale në alfabetin e Braille për personat e verbër dhe me shikim të dëmtuar.
- Siguroni transmetues ose programe për audio përshkrim, të cilat e bëjnë më të lehtë për personat e verbër dhe me shikim të dobët të ndjekin eventin.

4.SIGURIA PËR TË GJITHË

Për të garantuar sigurinë e të gjithë pjesëmarrësve në event, është e nevojshme të sigurohen dhe plotësohen kushtet e mëposhtme:

- kutia e ndihmës së parë të jetë në tryezën informative (reception);
- butoni i alarmit të zjarrit të jetë taktil dhe lehtësisht i dukshëm;
- aparatet për zjarr të jenë të vendosura në lartësinë e karrocave;
- rruga e evakuimit të jetë e qasshme për përdoruesit e karrocave dhe personat e verbër;
- të ekzistojë një sistem informacioni vizual i aksesueshëm për personat me dëgjim të dëmtuar.



Është e rëndësishme që pas çdo eventit të organizuar të vini sërish në kontakt me pjesëmarrësit dhe të verifikoni në komunikim të drejtpërdrejtë deri në çfarë mase ishte eventit i aksesueshëm për ta.



Më shumë detaje mbi organizimin e eventeve të aksesueshme, përfshirë një listë kontrolli, mund të gjeni në Udhëzimet për organizimin e eventeve të aksesueshme.

Shkarkoni udhëzimet nga adresa e internetit:

<http://caritalbania.org/category/broshura/>

Për të përmirësuar punën, ju lutemi vlerësoni tekstin.
Këtë mund ta bëni duke skanuar kodin QR ose nëpërmjet linkut

<https://forms.gle/CXiTFVyn91Vxd4wJ8>

Faleminderit!



Udhëzuesi për komunikim të aksesueshëm është krijuar si pjesë e projektit “Komunikimi i aksesueshëm drejt gjithpërfshirjes të grupeve të cënueshme në Ballkanin Perëndimor” i zbatuar nga Caritas Shqiptar, me qëllim të ndërgjegjësimit të publikut dhe të evidentimit të problemit të aksesueshmërisë së pamjaftueshme, por duke paraqitur gjithashtu zgjidhje të mundshme, pra këto janë udhëzime bazë për përmirësimin e aksesueshmërisë.

E drejta e autorit i përket Caritas Shqiptar. Ndalohet riprodhimi dhe shpërndarja pa pëlqimin me shkrim.

Caritas Shqiptar
www.caritalbania.org / 355 (0) 68 202 4596 /
caritalbania@caritalbania.org
Adresa: Rr. Don Bosko Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

